



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të Nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), Nenit 5, pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, Nenit 2, paragrafi 1 dhe 2, të Udhëzimit Administrativ Nr.14/2011, për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik:

PLOTËSIM I KONKURSIT

01 Nr.031-296861 TË DATËS 07.12.2016

Nr.	Niveli	Pozita	Vendi i lirë/Zëvendësim	Numri i pozitave
1	ShML	Mësimdhënës/e për profilin arsimor; Ndërtimtar	Vend i lirë	1

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), **certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara të noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit, nuk do të merret parasysh;**
- Certifikata që nuk jeni nën hetime.
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore **(nëse ka).**

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimorë

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimet Administrative përkatëse të MASHT-it (UA Nr. 05/2015 dhe UA Nr. 06/2015) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e profilin arsimor; Ndërtimtar në shkollë të mesme të lartë:

Msc. i ndërtimtarisë/arkitekturës;
Inxh. i dip. i ndërtimtarisë/arkitekturës

SQARIM: Në institucionet e arsimit të mesëm të ultë (6-9) dhe arsimit të mesëm të lartë (10-12), kandidatët duhet të kenë së paku 300 ETCS, përkatësisht 5 vite studime.

Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur për institucionet e arsimit të mesëm të ultë (6-9) dhe arsimit të mesëm të lartë (10-12), do të shqyrtohen dhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim të studimeve 4 vjeçar.

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT.

Për intervistë do të ftohet ata kandidat të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në web faqen e Komunës së Prishtinës <https://kk.rks-gov.net/prishtina/> (konkurset) dhe përmes e-mailit (sipas të dhënave në aplikacionin e kandidatit)

Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, nuk do të jetë domosdoshmërisht më datë 04.01.2017, por në varësi të lirimit real i vendit të punës në IEAA (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.)

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur nga data e publikimit me: **13.12.2016 deri më datën 21.12.2016.**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në komunë përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës.